

Koordinatori Kombëtar Antitrafik

Buletin Informativ

Nr. 16

Maj-Qershor-
Korrik-Gusht 2018

•••

*Takim i Mekanizmit
Kombëtar të Referimit,
14 maj 2018, Tiranë*

Më datë 14 maj në Ministrinë e Brendshme u zhvillua takimi i MKR-së, i fokusuar kryesisht tek iniciativa e ZKKA-së mbi krijimin e Bordit Këshillimor të Viktimave të Trafikimit, termat e tij të referencës, rekomandimet e Progres Raportit të BE-së, sugjerimet/komentet mbi Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2018-2020, marrja e masave për kalendarin e aktiviteteve ndërgjegjësuere verore, por edhe për çështje të tjera që duhet të trajtohen nga anëtarët e Mekanizmit Kombëtar të Referimit.

Në takim morën pjesë anëtarët e Marrëveshjes së Funkcionimit të Mekanizmit Kombëtar të Referimit: Zëvendësministrja për Evropën dhe Punët e

Jashtme, Znj. Artemis Dralo, Zëvendësministrja e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Znj. Ardiana Jaku, përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nga Shërbimi Social Shtetëror, nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, nga Ambasada Angleze, Organizatat Ndërkombëtare, IOM, World Vision, ARSIS dhe Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik, etj.



•••

*Takimi i Autoritetit
Përgjegjës
14 maj 2018, Tiranë*

Më 14 maj, u zhvillua takimi i Autoritetit Përgjegjës për të diskutuar mbi rastin e referuar nga organizata “Të Ndryshëm dhe Të Barabartë”.

Pas diskutimit për problematikat e hasura mbi rastin, pjesëmarrësit lanë detyra për marrje masash lidhur me zgjidhjen e këtij problemi.

Në takim morën pjesë anëtarët e Autoritetit Përgjegjës përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nga Shërbimi Social Shtetëror, nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik, etj.

•••

Trajnim mbi “Të drejtat e viktimave të veprës penale” 18 maj 2018, Tiranë

Më datë 18 maj, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave në bashkëpunim me organizatën “Të Ndryshëm dhe Të Barabartë” zhvilluan trajnimin me temë “Të drejtat e viktimave të veprës penale”. Në trajnim morën pjesë punonjës të DPPSH dhe DVP Tiranë dhe Durrës, përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe prokurorë të PP dhe PKR-së.



•••

Takim mbi “Përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve të shfrytëzuar për punë në vendet fqinje” 30 maj 2018, Kukës

Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave në bashkëpunim me Caritas Shqiptar, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Policinë e Kufirit dhe Migracionit, po zbatojnë

projektin “Fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve shtetërore në mbrojtje të fëmijëve që shfrytëzohen për punë në vendet fqinje”, i financuar nga Misioni i Përhershëm Francez në Kombet e Bashkuara dhe Organizatat Ndërkombëtare në Vienë. Takimi i parë u zhvillua në Kukës, më 30 maj dhe do të vijojë dhe me takime të tjera. Në këtë takim morën pjesë: përfaqësues nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, Policia e Kufirit dhe Migracionit, Policia Vendore e qarkut Kukës, anëtarë të Komitetit Rajonal dhe Tryezës Teknike, punonjës nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Shërbimi Social Shtetëror, Zyra e Punësimit, Organizata të Shoqërisë Civile, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Shëndetit Publik, Këshilli i Qarkut, Bashkia, etj.

Gjithashtu i pranishëm ishte edhe një delegacion i Republikës së Kosovës, i përfaqësuar nga punonjës së Policisë së Kosovës, Ministrisë së Punës dhe Mbrojtjes Sociale, përfaqësues të Zyrës së Koordinatorit Nacional, etj.



•••

Trajnim mbi “Të drejtat e viktimave të veprës penale” 30 maj 2018, Fier

Më 30 maj, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave në bashkëpunim me organizatën “Të Ndryshëm dhe Të Barabartë” zhvilluan trajnimin me temë “Të drejtat e viktimave të veprës penale”, financuar nga Bashkimi Evropian. Në trajnim morën pjesë punonjës të DPPSH dhe DVP Berat dhe Fier, përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe prokurorë të PP dhe PKR-së.



•••

Takime informuese 12-13 qershor 2018, Elbasan

Më datë 12 dhe 13 qershor, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Komitetin Rajonal Antitrafik dhe Organizatën Ndërkombëtare për

Migracionin (IOM) zhvilluan takime ndërgjegjësuere në Elbasan, lidhur me parandalimin e fenomenit të fëmijëve të pashoqëruar, kryesisht në Itali.



•••
Takime informuese
21-22 qershor 2018, Fier

Më datë 21 dhe 22 qershor, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Komitetin Rajonal Antitrafik dhe Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) zhvilluan takime ndërgjegjësuere në Fier, lidhur me parandalimin e fenomenit të fëmijëve të pashoqëruar, kryesisht në Itali.



•••
Takim informues
25 qershor 2018, Tiranë

Më datë 25 qershor, u organizua në Ministrinë e Brendshme takimi informues me temë “Punonjësit e pushtetit vendor vënë në lëvizje mekanizmat kundër trafikimit të personave dhe dhunës ndaj grave”. Në takim morën pjesë rreth 45 persona, këshilltar dhe anëtarë të Tryezave Teknike të Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit, dhe përfaqësues nga Drejtoritë Vendore të Policive të këtyre qarqeve, nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoritë e Shërbimeve Sociale, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, OJF,



etj.

•••
Takim mbi “Përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve të shfrytëzuar për punë në vendet fqinje”
27 qershor 2018, Shkodër

Më datë 27 qershor, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave në bashkëpunim me Caritas Shqiptar zhvilluan në Shkodër takimin mbi “Përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve të shfrytëzuar për punë në vendet fqinje”. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, Policia e Kufirit dhe Migracionit, Policia Vendore e qarkut Shkodër, anëtarë të Komitetit Rajonal dhe Tryezës Teknike, punonjës nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Shërbimi Social Shtetëror, Zyra e Punësimin, Organizata të Shoqërisë Civile, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Shëndetit Publik, Këshilli i Qarkut, Bashkia, etj. Gjithashtu ishte i pranishëm edhe një delegacion i Republikës së Malit të Zi, i përfaqësuar nga Koordinatori Nacional dhe përfaqësues të Zyrës së Koordinatorit Nacional, punonjës së Policisë së Malit të Zi, Ministrisë së Punës dhe Mbrojtjes Sociale.



...
**Inaugurimi i Instilacionit
ndërgjegjësues #UNË JAM
SI TI!**

30 Korrik 2018, Tiranë

Më datë 30 korrik, Ministria e Brendshme/ Zyra e Koordinatorit Kombëtar të Luftës kundër Trafikimit të Personave në bashkëpunim me organizatën “Të ndryshëm & Të Barabartë” zhvilluan në ambientet e Parkut “Rinia” ceremoninë e instilacionit ndërgjegjësues #UNË JAM SI TI!. Për herë të parë në Shqipëri, një grup vajzash që i kanë mbijetuar trafikimit, kanë ndërmarrë dhe realizuar me shumë përkushtim dhe dashuri fushatën ndërgjegjësuese “UNE JAM SI TI! UNË IA DOLA MBANË! EDHE TI MUNDESH!”. Mjaft qytetarë dhe të rinj u bënë pjesë e aktivitetit për t’ju treguar vetë viktimave, sesa vlerë ka nisma dhe angazhimi i tyre, për të treguar solidaritetin e tyre me viktimat e trafikimit dhe për nismën në fjalë. Gjatë aktivitetit, pjesëmarrësit përçollën mesazhe të dedikuara për të mbijetuarat e trafikimit.



...
**Hapja e Fushatës verore
“Un Gift Box”
30-31 korrik dhe 1 gusht
2018, Vlorë**

Më datë 30-31 korrik, në ditën Ndërkombëtare kundër Trafikimit të Personave, Ministria e Brendshme/Zyra e Koordinatorit Kombëtar të Luftës kundër Trafikimit të Personave në bashkëpunim me rrjetin “URAT” sollën për herë të tretë në Shqipëri Inicativën Globale të Kombeve të Bashkuara për Luftën Kundër Trafikimit-UN GIFT BOX.

Aktiviteti u lançua në Vlorë, me pjesëmarrjen e Znj. Rovena Voda, Zëvendësministre e Brendshme dhe Koordinatore Kombëtare e Luftës kundër Trafikimit, Znj. Artemis Dralo, Zëvendësministre për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe përfaqësues të rrjetit “URAT”, të Institucioneve lokale antitrafikim dhe organizatave kombëtare e ndërkombëtare. UN GIFT BOX qëndroi e hapur për tre ditë në këtë qytet, nga

data 30 Korrik deri më 1 Gusht 2018.



...
**Takim i Mekanizmit
Kombëtar të Referimit,
6 gusht 2018, Tiranë**

Më datë 6 gusht 2018, në Ministrinë e Brendshme u zhvillua takimi i radhës i MKR-së.

Takimi u fokusua kryesisht tek iniciativa e ZKKA-së mbi temat e referencës së Bordit Këshillimor të Viktimave të Trafikimit, rekomandimet e TIP Raportit të DASH-it, marrja e masave për kalendarin e aktiviteteve ndërgjegjësuese të Muajit Antitrafik, por edhe për çështje të tjera që duhet të trajtohen nga anëtarët e Mekanizmit Kombëtar të Referimit.

Në takim morën pjesë anëtarët e Marrëveshjes së Funkcionimit të Mekanizmit Kombëtar të Referimit: Zëvendësministria e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Znj. Ardiana Jaku, përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nga Shërbimi Social

Shtetëror, nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, nga Ambasada Angleze, Organizatat Ndërkombëtare, IOM, World Vision, ARSIS dhe Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik, etj.



për identifikimin dhe mbrojtjen e grupeve vulnerabil migrantë në Ballkanin Perëndimor - FAZA II”.

Në trajnim morën pjesë rreth 30 persona, përfaqësues nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin Gjirokastër, Anëtarë të Tryezës Teknike dhe organizata që operojnë në qarkun Gjirokastër.



Trajnimi mbi
“Identifikimin dhe referimin e kategorive të cenueshme në flukset migratore”,
23 gusht 2018, Gjirokastër

Më datë 23 gusht, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave në bashkëpunim me Komitetin Rajonal Antitrafik, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (Departamenti për Kufirin dhe Migracionin), Drejtorinë e Antitrafikut dhe Migracionit, Drejtorinë e Azilit dhe Shtetësisë, si dhe Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), zhvilluan trajnimin me temë “Identifikimi dhe referimi i kategorive të cenueshme në flukset migratore”, në zbatim të projektit “Ngritja e kapaciteteve dhe mekanizmat